

“ANGERBA” shpk

RAPORT PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

**“RIKONSTRUKSION DHE ASFALTIM I RRUGES SE FSAHTIT GURRE , NJESIA
ADMINISTRATIVE QUKES”**

BASHKIA PRRENJAS



Shtator 2024

TABELA PERMBLEDHESE

1. INFORMACION PER QELLIMIN E VNM DHE METODIKEN E ZBATUAR
2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET
PROJEKTI, SHOQËRUAR DHE ME FOTOGRAFI;
3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE, NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA
PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË TIJ;
4. INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TË MUNDSHME, NEGATIVE, NË
MJEDIS, TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR;
5. NJË PËRSHKRIM PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË
NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMA, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE;
6. INFORMACION PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË
IDENTIFIKUARA;
7. TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS,
QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT, DHE VLERAT E
NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË;
8. MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË
MJEDISIT TË NDIKUAR TË SIPËRFAQES NË GJENDJEN E MËPARSHME, SI DHE KOSTOT
FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN;
9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË
MJEDIS;
10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË
TILLË).

1. INFORMACION PER QELLIMIN E VNM DHE METODIKEN E ZBATUAR

Shqipëria, si palë nënshkruese e një numri konventash ndërkombëtare, kontratave dhe dokumentave të tjera ligjore është e detyruar të zbatojë një sistem efektiv për administrimin e tokës, ujit dhe ajrit, jo vetëm në drejtim të zgjidhjes së problemit, por edhe të zbatimit të përgjegjësive të saj nën këto marrëveshje ndërkombëtare.

Mbrojtja e mjedisit, si një sistem dinamik, që ndryshon herë pas here fizikisht dhe biologjikisht, duhet parë në tërësinë e faktorëve natyrorë dhe të veprimit njerëzor që ushtrohet mbi të. Zhvillimi urban jep një ndikim të caktuar, duke goditur pak a shumë natyrën përreth, sidomos kur parametrat e ndërtimit dhe të menaxhimit të tij nuk analizohen konform ligjeve e rregullave të natyrës, në dobi të ruatjes së ekuilibrave e të ekosistemeve të saj.

Një ndër burimet e ndotjes së tokës, ujit dhe ajrit janë zhvillimet urbane, që sipas natyrës dhe mënyrës teknike të aplikuar shkaktojnë ndotje, me sasi dhe natyra të ndryshme, midis të cilave më të rëndësishme janë:

- Gjatë operacioneve të ndërtimit, dhe pastaj edhe të funksionimit;
- Sistemi teknologjik i furnizimit me lëndë të parë dhe eliminimi i mbetjeve të tyre;
- Sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit;
- Sistemi mbrojtës nga përmytjet dhe rreziqet e mundshme natyrore;

Metodat e uljes së ndotjes, në zhvillime urbane si qendra banimi, biznesi, shlodhëse, etj, konsistojnë në perfeksionimin e teknikave të mirëmbatjes dhe mirë menaxhimit të zonave të komplekseve të ndërtimit, por mbi të gjitha në marrjen e masave kundrejt atyre faktorëve që mund të ndikojnë negativisht ndaj parametrave natyror e shëndetësor. Këto ndërtime japin një efekt të caktuar, duke goditur pak a shumë natyrën përreth, sidomos kur parametrat e ndikimit të saj nuk analizohen konform ligjeve e rregullave të natyrës, në dobi të ruatjes së ekuilibrave e të ekosistemeve të saj.

Nxitja e tyre kërkon një përkujdesje më të madhe nga ana e organeve legislative dhe vendimmarrëse, në mënyrë që të rritet interesi për ndërtime dhe aktivitete të tilla, si dhe shoqëria investuese duhet të tregojë interes, si për zhvillimet në fushën e ndërtimit, dhe në ruatjen e ekuilibrave natyror, dhe veçanërisht në ruatjen e ekosistemeve.

1.1- Pershkrimi i pergjithshem

Zona e projektit shtrihet ne zonen lindore te Shqiperise ne qarkun e Elbasanit. Pozita gjeografike e ketij rajoni vleresohet si shume e favorshme per zhvillimin e tij ekonomik, e cila lidhet me

faktin se rajoni tradicionalisht ka sherbyer si zone me prodhim te larte bujqesor dhe blegtoral per tregun vendas dhe eksport.

Projekti permban Rikonstruksionin dhe Asfaltimin e Rruges se fshatit Gurre ne Njesine Administrative Qukes te Bashkise Prrenjas. Segmenti i rruges qe do te trajtohet me gjatesi 2 165 ml fillon ne rrugen e asfaltuar qe shkon per ne fshatin Berzeshte dhe perfundon ne qender te fshatit Gurre.

Aktualisht rruga eshte e shtruar me cakell e zhavorr.

Sistemi i rrjetit te kanalizimeve ne rrugen ekzistuese pothuajse nuk egziston.

Te gjitha ujrat e shiut pergjithesisht shkarkojne ne trupin e rruges dhe me pas tek tombinot ekzistuese dhe prej aty ne perroin e Zharrit qe me tej derdhet ne Lumin Shkumbin.

Projekti parashikon disiplinimin e ujerave te bardha ne te gjithe rrugen.

1.2- Kuadri Ligjor i Permbledhur

Ky Raport Paraprak i Vleresimit dhe Ndikimit ne Mjedis eshte hartuar duke patur parasysh Legjislacionin e Shtetit Shqiptar dhe te Komunitetit European, me akte juridike ligjore dhe nenligjore specifikke qe rregullojne ushrimin e aktivitetit te investimeve dhe gjithashtu aktet ligjore lidhur me mbrojtjen e mjedisit si me poshte:

1. Ligji per Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 8934, dt. 23.01.2003, 05.09.02 neni 26 “Procesi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.
2. Ligji Nr. 8990, date 23.01.2003, neni 8 dhe 9 “Mbi vleresimin e ndikimit ne mjedis”
3. Ligji ”Leja per veprimtarite qe ndikojne ne mjedis”
4. Ligji “Per token” nr. 7501 dt. 27.01.1995
5. Udhzues Nr. 6 i Ministrise se Mjedisit, date 27.12.2006 “Per miratimin e metodologjise se vleresimit paraprak te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie”
6. VKM per “Sigurimin dhe Informacionin e Mjedisit e Drejta e Publikut per Informacion”, dt. 06.01.1998
7. Ligji nr. 8990, dt. 23.01.2003 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”.
8. Ligji Nr. 10440, dt. 07.07.2011 “ Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”.
9. Ligji Nr. 12/2015 “ Per disa ndryshime ne ligjin Nr. 10440 date 07.07.2011.
10. Ligji 10006, date 23.10.2008 “Per mbrojtjen e faunes se eger”
11. Ligji 9587, date 20.07.2006 “Per mbrojtjen e biodiversitetit”

12. Ligji 8906, date 06.06.2002 “Per zonat e mbrojtura” i ndryshuar
13. VKM Nr.686, date 29.07.2015 “ Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit te deklarates mjedisore.
14. Ligji Nr.128/2020 “ Per disa ndryshime e shitesa ne Ligjin Nr.10440 date 07.07.2011.”Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” te ndryshuar.

1.3- Karakteristikat fizike

Klima


Ne zonen e Prrenjasit , vererat jane kryesisht te nxehta ,te thata dhe kryesisht pa re , ndersa dimrat jane shume te ftohte dhe pjeserisht me re.

Gjate vitit temperatura mesatare varion nga 2°C deri ne 27°C dhe ne raste shume te rralla eshte nen -8°C ose mbi 31°C .

Reshjet jane ne formen e shiut dhe te debores.

Te dhenat e meposhtme jane te siguruar nga uebsajti : *weatherspark.com*.

Ne tabelle paraqiten karakteristikat e pergjithshme te klimes ne Prrenjas pergjate 12 muajve te vitit.




Regjimi i rrezatimit

Gjatesia e dites ne Prrenjas ka lekundje domethenese gjate periudhave te ndryshme te vitit. Gjate vitit 2024 dita me e shkurter eshte parashikuar te jete data 21 Dhjetor me nje gjatesi prej 9 oresh e 13 minuta dite, nderkohe qe dita me e gjate ka qene me 20 Qershor me 15 ore e

“ANGERBA” shpk

8 minuta dite. Ne grafikun e meposhtem paraqiten te dhenat e mesiperme. Vija e zeze perfaqeson numrin e oreve kur dielli eshte i dukshem, ndersa ngjyrat nga poshte lart perfaqsojne ditene e plote (ngjyra e verdhe), muzgun (pjesa e ndermjetme mbi vijen e zeze) si dhe naten e plote.(ngjyra gri).




Gjithashtu te dhenat mesatare mujore te oreve me drite paraqiten te permbledhura dhe ne tabelen e meposhtme :

Hours of	Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec
Daylight	9.6h	10.6h	12.0h	13.3h	14.5h	15.1h	14.8h	13.8h	12.4h	11.1h	9.9h	9.3h

Lindja me e shpejte e diellit eshte ne oren 05:04 me date 14 Qershor nderkohe qe lindja me e vonë eshte 1 ore e 58 minuta me vonë me daten 4 Janar ne oren 07:03. Perendimi me i shpejte eshte ne daten 7 Dhjetor ne oren 16:09, ndersa perendimi me i vonë eshte 4 ore e 5 minuta me vonë me daten 27 Qershor ne oren 20:14.


Keto te dhena te permendura paraqiten dhe ne grafikun e meposhtem i cili jep dhe datat e ndryshimit te ores (pra zgjatjen e dites sic e quajme).



Temperatura e ajrit

Sezoni i nxehte zgjat per 3.1 muaj nga data 9 Qershor deri me daten 12 Shtator me nje temperature mesatare maksimale mbi 23°C. Muaji me i nxehte ne Prrenjas eshte Korriku me nje temperature mesatare maksimale prej 27°C dhe nje temperature mesatare minimale prej 14°C. Sezoni i ftohte zgjat per 3.7 muaj nga 23 Nentori deri me 13 Mars me nje temperature mesatare maksimale nen 10°C. Muaji me i ftohte i vitit eshte muaji Janar me nje mesatare minimale -2°C dhe nje temperature mesatare maksimale 6°C.

Me poshte keto te dhena paraqiten ne menyre grafike dhe tabelare.Me vije te kuqe tregohet temperatura mesatare maksimale, me vijen blu temperatura mesatare minimale dhe me pika tregohen perkatesisht temperaturat ashtu sic ndihen apo perceptohen nga njeriu.



Average	Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec
High	6°C	7°C	10°C	15°C	19°C	24°C	27°C	27°C	22°C	17°C	11°C	7°C
Temp.	2°C	3°C	6°C	10°C	14°C	18°C	21°C	21°C	17°C	12°C	7°C	3°C
Low	-2°C	-1°C	1°C	5°C	9°C	12°C	14°C	14°C	11°C	7°C	3°C	-1°C

Lagështira relative mesatare e ajrit në %.


Llogaritja e lagershtires bazohet ne te ashtuquajturen “piken e veses” apo piken e shkrirjes. Kur pika e shkrirjes eshte e ulet, ajri ndihet me i thate, ndersa kur pika e shkrirjes eshte me e larte, ajri ndihet me i lagesht. Ndryshe nga temperature e cila mund te pesoje ndryshime drastike

“ANGERBA” shpk

midis dites dhe nates, pika e shkrirjes ka tendencen te levize ne menyre me te ngadalte, prandaj nese temperature psh ulet gjate nates, nje dite me ajer me lageshtire shoqerohet zakonisht nga nje nate po me ajer me lageshtire.

Niveli i lageshtires ne Prrenjas nuk ka ndonje ndryshim pergjate vitit, pra periudhat me lageshtire shume te madhe te cilat shkaktojne mungese rehatie (ngjyra roze dhe e kuqe grafikisht) qendrojne nen 1%.

Me poshte paraqiten grafikisht dhe ne menyre tabelare te dhenat e permendura me sipër :



	Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec
Muggy days	0.0d	0.0d	0.0d	0.0d	0.0d	0.4d	0.8d	0.6d	0.1d	0.0d	0.0d	0.0d

Reshjet atmosferike

Nje dite e lagesht konsiderohet kur ka te pakten 1 mm reshje. Mundesite e diteve me reshje ne Prrenjas variojne sipas stineve.

Sezoni i reshjeve zgjat 8.5 muaj nga 22 Shtatori deri me 6 Qershor me nje mundesi me te madhe se 22% qe nje dite te jete me reshje. Muaji me ditet me te shumta me reshje eshte Nentori me nje mesatare prej 9.3 ditesh me te pakten 1 mm reshje.

Sezoni i thate zgjat 3.5 muaj nga 6 Qershori deri me 22 Shtator. Muaji me ditet me te pakta me reshje eshte Korriku me nje mesatare 3.5 dite me te pakten 1 mm reshje.

“ANGERBA” shpk

Ndermjet diteve me reshje vecohen ditet ne te cilat kemi vetem reshje shiu, vetem reshje debore, apo ditet ne te cilat kemi dhe reshje shiu dhe reshje debore. Muaji me me shume dite me reshje shiu eshte Nentori me nje mesatare 8.7 dite. Bazuar ne kete kategorizim forma me e shpeshte e reshjeve ne zonen e Prrenjasit eshte vetem shiu me nje mesatare maksimale te perqindjes se renies prej 32% ne daten 20 Nentor.

Me poshte paraqiten te dhenat ne menyre grafike te mundesive te renies se reshjeve dhe te permbledhura ne tabele.



<i>Ditet me</i>	<i>Jan</i>	<i>Feb</i>	<i>Mar</i>	<i>Apr</i>	<i>May</i>	<i>Jun</i>	<i>Jul</i>	<i>Aug</i>	<i>Sep</i>	<i>Oct</i>	<i>Nov</i>	<i>Dec</i>
<i>Shi</i>	5.7d	6.0d	6.7d	8.3d	7.6d	5.4d	3.5d	4.4d	6.2d	7.9d	8.7d	7.9d
<i>Shi+Bore</i>	1.5d	1.5d	0.6d	0.2d	0.0d	0.0d	0.0d	0.0d	0.0d	0.1d	0.5d	1.1d
<i>Bore</i>	0.4d	0.4d	0.1d	0.0d	0.0d	0.0d	0.0d	0.0d	0.0d	0.0d	0.1d	0.4d
<i>Shi ose Bore</i>	7.6d	7.9d	7.4d	8.5d	7.6d	5.4d	3.5d	4.4d	6.2d	8.0d	9.3d	9.5d

Ditet me shi

Per te treguar levizjet Brenda nje muaji dhe jo vetem totalet mujore , llogaritja eshte kryer brenda nje 31-ditori te levizshem te perqendruar rreth cdo dite te vitit.


Miloti perjeton ndryshime domethenese sezonale te reshjeve mujore.

Reshjet e shiut bien gjate gjithe vitit ne Prrenjas. Muaji me me shume shi eshte Nentori me nje mesatare pre 83 milimetrash.

Muaji me me pak shi eshte Korriku me nje mesatare prej 19 mm shi.

Me poshte paraqiten grafiki dhe te permbledhura te dhenat e mesiperme per cdo muaj te vitit.

“ANGERBA” shpk



	Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec
Shiu (mm)	45.6 mm	48.5 mm	45.1 mm	50.1 mm	39.0 mm	28.1 mm	18.8 mm	25.3 mm	53.6 mm	68.5 mm	82.9 mm	63.9 mm

Debora


Njesoj si me shiun do te marrim parasysh sasine e debores te akumuluar ne nje periudhe 31 ditore te levizshme te perqendruar rreth cdo dite te vitit.

Prrenjasi perjeton disa ndryshime sezonale persa i perket reshjeve te debores.

Periudha me debore zgjat rreth 3.6 muaj nga data 24 Nentor deri me 12 Mars ku kemi mesatarisht rreth 25 mm debore. Muaji me me shume reshje debore eshte Janari me nje mesatare prej 62 mm.

Periudha pa debore zgjat per 8.4 muaj nga data 12 Mars deri me 24 Nentor. Dita me me pak debore eshte rreth dates 22 Korrik ku nuk regjistrohen fare reshje debore.

Me poshte paraqiten te dhenat e mesiperme ne forme grafike gjithashtu edhe tabelare.



	Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec
Debora (mm)	62.1	60.4	20.9	5.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	2.3	17.0	57.8

Era

Ne kete pjese diskutohet mesatarja orare e vektorit te eres (shpejtesia dhe drejtimi) ne nje lartesi 10 m mbi nivelin e tokes. Era e perceptuar ne cdo lokacion gjeografik eshte shume e varur nga disa faktore sic jane, topografia, bimesia etj, prandaj ne nje moment te caktuar shpejtesite e eres kane diapason levizjeje me te gjere sesa mesataret orare te matura.

Shpejtesia mesatare orare e eres ne Prrenjas peson ndryshime te medha gjate vitit ne varesi te stineve.


The *windier* part of the year lasts for *5.4 months*, from *November 9* to *April 23*, with average wind speeds of more than *2.8 meters per second*. The *windiest* month of the year in Përrenjas is *February*, with an average hourly wind speed of *3.2 meters per second*.

The *calmer* time of year lasts for *6.6 months*, from *April 23* to *November 9*. The *calmest* month of the year in Përrenjas is *August*, with an average hourly wind speed of *2.4 meters per second*.

Pjesa me erera me te shumta e vitit zgjat 5.4 muaj nga 9 Nentori deri me 23 Prill me nje mesatare me te madhe se 2.8 m/s. Muaji me me shume ere ne Prrenjas eshte muaji Shkurt me nje shpejtesi mesatare orare te eres qe arrin 3.2 m/s.

Periudha me e qete pa erera zgjat 6.6 muaj nga data 23 Prill deri me 9 Nentor.


Muaji me i qete ne aspektin e ererave eshte Gushti, me nje shpejtesi mesatare orare prej 2.4 m/s.



	Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec
Shpejtesia e eres (m/s)	3.1	3.2	3.1	2.9	2.6	2.5	2.5	2.4	2.4	2.6	2.9	3.1

Te dhena te permbledhura per cdo muaj jane dhene ne grafikun dhe tabelen e mesiperme, aty ku vihen re luhatjet e shpejtesive mesatare pergjate muajve.

Me poshte paraqitet ne menyre grafike dhe drejtimi i eres ne zonen e Prrenjasis pergjate muajve te vitit.



Drejtimi mesatar orar predominues ne Prrenjasis varion pergjate vitit.

Era me se shumti fryn nga Perendimi per 6.2 muaj nga data 22 Mars deri me 27 Shtator me nje perqindje maksimale 51% me daten 12 Qershor. Era me se shumti fryn nga lindja per 5.8 muaj, nga data 27 Shtator deri me 22 Mars me nje perqindje maksimale prej 45 % me daten 1 Janar.

Ngjarjet e pazakonta klimaterike

Nder dukuritë e pazakonta klimatike bëjnë pjesë edhe ato që lidhen me regjimin e reshjeve. Zona jonë si pjesë e një rajoni siç është Shqipëria, me klimë tipike mesdhetare, karakterizohet nga një regjim i çrregullt i reshjeve nga pikëpamja e shpërndarjes vjetore. Kjo shpërndarje karakterizohet nga një maksimum në muajt e dimrit (30-40% e reshjeve vjetore) dhe një minimum në muajt e verës (10%). Çrregullsia e reshjeve vihet re edhe në shpërndarjen e tyre gjeografike. Kështu, në shkallë lokale herë pas here ndodhin me ngjarje jo të zakonshme si reshjet intensive brenda 24 orëve të shoqëruara në disa raste me përmbajtje apo mungesa e theksuar e reshjeve që sjell thatësira të zgjatura.

Rajoni i studiuar karakterizohet nga një sasi jo e vogël reshjesh, rreth 1200-1300mm në vit. Të shpërndara si vijon: në dimër rreth 420mm, në pranverë rreth 340mm, në verë rreth 150mm dhe në vjeshtë rreth 360mm. Në vitet e ardhshme (sipas UNEP, 1994) pritet që deri në vitin 2100, si rezultat i ngrohjes globale, të ndodhë një ndryshim i temperaturës mesatare vjetore me 0,7-2,5°C, gjë e cila do të pasqyrohet edhe në ciklin hidrologjik.

Gjatë dimrit pritet që rritja e temperaturës të ndjekë ecurinë vjetore, ndërsa sasia e reshjeve do të zvogëlohet deri me 5%. Gjatë pranverës temperaturat mesatare që ndryshojnë mes 13,8 dhe 15,7°C mendohet të ndryshojë në 15,2°C dhe 18,5°C, ndërsa sasia e reshjeve do të rritet me 0,18%. Gjatë verës temperaturat mesatare do të luhaten nga 23,2°C në 24,7°C, ndërsa sasia e reshjeve do të zvogëlohet me 60%. Gjatë vjeshtës ndryshimi i temperaturës pritet të jetë më i madh se ai vjetor, për shkak të verës së zgjatur, ndërkohë që sasia e reshjeve pritet të rritet me 53%.

1.4- Gjeologjia


Formacionet gjeologjike

Ne ndertimin gjeologjik te zones sone takohen depozitimet e meposhtme:

alQh₂ – Depozitimet aluviale te Holocenit te perfaqesuara nga zhavorre, rera e popla me nje asortim te keq.


d,c,pQh – Depozitimet e perziera (deluvione, proluvione, aluvione e depozitime shpatore) te Holocenit te perfaqesuara nga argjila, zhavorre, rera e alevrite me nje asortim te keq.

N₁²a – Depozitimet mollasike te Miocenit (Formacioni Librazhdi) te perfaqesuara nga nderthurje ranoresh dhe konglomeratesh.




**FRAGMENT NGA HARTA GJEOLIGJIKE E ZONES NEN STUDIM
PLANSHETI K-34-101-D-d BERZESHTA**


LEGJENDA



Holocen. Aluvione te shtratit, zhavore, rera, popla



Holocen. Depozitime të përziera aluviale-proluviale: rëra, zhavore, alevrite.



Miocen i Mesëm. Konglomerate, ranorë të kuqerremtë (a-Formacioni i Librazhdit) dhe ranorë, alevrolite e qymyre (b- Formacioni Goliku).

KOLONA LITOSTRATIGRAFIKE
PLANSHETI K-34-101-D-d BERZESHTA

Tekonika.

Nga pikepamja tektonike zona nen studim ben pjese ne Ultesinen Albano-Thesaliane, mbi zonen ndermalore te Librazhdit (Gropa e Librazhdit).


Gropa e Librazhdit ka nje shtrirje 40km. e gjeresi rreth 4-8km. Lugina e Shkumbinit prane shtratit eshte e ngushte me faqen perendimore me te thepisur me pak te stabilizuar e me shume rreshqitje. Ajo pershkohet nga perrenj te vegjel por me erozion agresiv. Faqja lindore ose e djathte eshte me e stabilizuar me perrenj te gjate por me erozion me te qete. Tre deri kater tarraca lumore por me zhvillim te kufizuar verehen ne rjedhjen e mesme te Shkumbinit prane Librazhdit. Ne gropen e Librazhdit prane dyshemese se Miocenit te mesem ne krahun lindor kemi edhe nje pako proluviale gravitative dhjetra metra e trashe me blloqe pak ose aspak te rrumbullakosur deri ne 1-2 m. e me perberje shkembinjsh vendas (gelqerore kretake, triasike e magmatike). Ajo flet per levizje te fuqishme ngritese ne buzen e gropes ne stadin e fillimit te formimit te saj dhe ne nje fare menyre sherben si indikator e fillimeve te formimit te relievit ne Shqiperi. Gjate rruges zbulohen dritare erozionale te vogla me mergele te Eocenit nen molasat kuqerreme.

Mioceni i mesem, ne Ultesiren (gropen) e Librazhdit ka trashesi rreth 900m. e mund te kete zanafille nga Seravaliani. Poshte ka nje formacion kontinental te kuqeremte, kryesisht konglomeratik e ranor, kurse siper formacione gri terigjene e me qymyr me karakter detar e lagunor.

Gropa e Librazhdit ka pamje sinklinale. Ne disa vende ne buzen lindore (Pishkash e Bushtrece) komplikohet me tektonika te vogla shkeputese. Krahu lindor vendoset kryesisht mbi ultrabaziket e masivit te Shebenikut por ne disa raste edhe mbi depozitimet e Kretakut te siperme ose te Eocenit apo Oligocenit.

Qendra e sinklinalit, ku kalon edhe lumi i Shkumbinit eshte e ngushte, mbasi krahu perendimor peson nje kthese te pernjehereshme me renie per ne lindje duke u shndruar shpejt ne nje krah me renie vertikale e pastaj te permbysur per ne perendim duke i dhene keshtu sinklinalit pamjen e nje strukture asimetricke e te permbysur.

SKEMA TEKTONIKE E ALBANIDEVE



Kushtet Gjeologo-Inxhinjrike

Per kryerjen e studimit gjeologo-inxhinjrik te sheshit te ndertimit ne fjale grupi i studimit kreu rikonjicionin gjeologo-inxhinjrik te trasese se rruges, ku theksojme se ajo eshte egzistuese dhe do te kerkoje kryesisht zgjerim e asfaltim te saj, si dhe shfrytezoi materialin arkival nga studime te mepareshme te kryer nga autoret ne zonen ne fjale. Gjate rikonjicionit te kryer se bashku me palen projektuese u konstatua se:

- Traseja eshte teresisht e hapur dhe e shtruar me material cakellor. Vende vende ajo kufizohet me mure apo gardhe te godinave apo parcelave te ndryshme.



“ANGERBA” shpk

- Mungese apo bllokim te kanaleve anesore, gje qe sjell ne periudhat uje-shume kalimin e ujerave siperfaqesor te shpatit mbi trasene e rruges.



Si pasoje e mungeses apo bllokimit te ketyre kanaleve ujerat siperfaqesore qe vijne nga shpati levizin ne menyre te pakontrolluar mbi trasene e rruges. Ky fakt do te kerkoje me domosdoshmeri marrjen e masave nga ana e projektit.

- Kalimi i disa kanaleve e perroskave te vogla eshte realizuar me anen e disa tombinove te cilet jane ne gjendje funksionale por te amortizuar. Gjate rikonjicionit u percaktua se keto kanale apo perroska te vogla intersekojne trasene e rruges ne: Pk.-5, Pk.-10, Pk.-14, Pk.-22, Pk.-24, Pk.-28, Pk.-32, Pk.-34, Pk.-36.5, Pk.-43, Pk.-55, Pk.-61, Pk.-63, Pk.-64, Pk.-75, Pk.-78, Pk.-92, Pk.-96, Pk.-99, Pk.-107, Pk.-108, Pk.-118.



Foto te tombinove egsiztuese

- Gjate rikonjcionit te kryer se bashku me palen projektuese nuk u konstatuan fenomene negative gjeologo-morfologjike. Por theksojme faktin se traseja ne segmentet Pk.75-Pk.84, Pk.91-Pk.106 & Pk.124-Pk.128 do te kaloje ne zona qe paraqesin nje pjeresi te kosiderueshme.

Fakt qe duhet mare ne konsiderate nga ana e projektit.

- Gjate rikonjcionit te kryer se bashku me palen projektuese u evidentuan dhe disa segmente ne te cilat si pasoje e prezences se perroskave, mbrojtjes nga prurjet e ngurta te shpatit, etj nga ana e projektit eshte vendosur te ndertohen mmure mbrojtese betoni. Keto segmente jane Pk.21-Pk.22, Pk.41-Pk.42.5, Pk.46-Pk.49.5, Pk.61-Pk.63.5, Pk.68-Pk.70, Pk.73-Pk.75, Pk.79-Pk.83, Pk.95.5-Pk.97.5, Pk.104.5-Pk.106.5, Pk.122-Pk.132. **Per te gjithë keto segmente rekomandojme qe muret te inkastrohen ne formacionet flishore te fresketa. Formacionet flishore paraqesin nje perajrim te theksuar dhe kemi vende vende tjetersimin e tyre ne formacione dherore.**

Gjate rikonzicionit gjeologo-inxhinerik u evidentuan dhe zhveshjet natyrale te zones ku rezulton se traseja e rruges kalon mbi material mbushes te perfaqesuar nga cakull dhe zhavorre kryesisht te perberjes karbonatike si dhe token natyrale si dhe suargjila me rrenje bimesh. Kjo shtrese ka nje trashesi qe luhetet nga 0.2 deri ne 1.5 ml e rralle me teper. Theksojme qe keto depozitime jane hedhur ne menyre kaotike dhe paraqesin nje trashesi dhe perberje shume heterogjene. Nen keto depozitime pozicionohen depozitimet deluvialo-eluviale te perbera nga suargjila me copra shkembinjsh flishore. Keto depozitime kane nje trashesi qe luhetet nga 1.0 deri ne 1.5ml e rralle me teper. Kalimi nga keto depozitime ne depozitimet e formacionit baze te perajruar te tipit flishor eshte gradual. Formacionet flishore paraqesin nje perajrim te theksuar dhe kemi vende vende tjetersimin e tyre ne formacione dherore.

Treguesit fiziko-mekanik te depozitime deluvialo-eluviale te meren:

Lageshti natyrale.....	$W_n=21.30\%$
Pesha specifike	$\gamma = 2.71 \text{ gr/cm}^3$
Pesha e volumit ne gjendje natyrale	$\Delta= 1.92 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n= 4.2 \%$
Kendi i ferkimit te brendeshem.....	$\varphi=23^\circ$
Kohezioni.....	$c=0.25 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i elasticitetit	$E = 150\text{kg/cm}^2$
Treguhesi i CBR.....	4-6%



Depozitimet deluvialo-eluviale ne zonen e studimit

Treguesit fiziko-mekanik te depozitime mollasike (shume te perajruar) te meren:

Lageshti natyrale.....	$W_n=12.50\%$
Pesha specifike	$\gamma = 2.72 \text{ gr/cm}^3$
Pesha e volumit ne gjendje natyrale	$\Delta = 2.14 \text{ gr/cm}^3$
Kendi i ferkimit te brendeshem.....	$\varphi=28^\circ$
Kohezioni.....	$c=0.35 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i elasticitetit	$E = 300 \text{ kg/cm}^2$
Treguhesi i CBR.....	8-10%




Depozitimet flishore ne zonen e studimit

-Per te gjithë trasene nisur nga pjeresia e terenit, prezenses se perroskave malore si dhe perajrimet intensive te formacioneve flishore, per shmangjen e lindjes se fenomeneve negative gjeologo-morfologjike rekomandojme qe punimet te kryen ne kohe te thate si dhe mos te jene masive. Rekomandojme inkastrimin e masave mbrojtese ne formacione te qendueshme.

1.5-Sizmiciteti

Zona jone e studimit, ku do te ndertohet objekti nen studim bazuar ne harten e Rajonizimit Sizmik te Republikes Shqiperise, karakterizohet nga lekundje sizmike prej 7 ballesh.



Harta e Rajonizimit Sizmik te Republikes Shqiperise.

2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI, SHOQËRUAR DHE ME FOTOGRAFI

Nga pikpamja floristike kjo hapësirë bën pjesë në zonën e shkurreve dhe dushqeve mesdhetare e cila shtrihet nga niveli i detit dhe deri në lartësinë më të madhe të saj. Këtu vegjetojnë shumë lloje të vendit tonë që përveç vlerave prodhuese kanë dhe vlera mbrojtëse, rekreative e turistike. Hapësira ka florë me një gamë të gjerë llojesh, madje shumë lloje kanë edhe vlera të rëndësishme mjekësore, industriale, ushqimore dhe dekorative, duke mbartur kështu edhe vlera ekonomike. Bimësia natyrore, arealet më të përhapura siç e theksuam më sipër i ka në territoret kodrinore dhe në brigjet e lumenjve. Mbulesa bimore përbëhet nga shkurre mesdhetare të përfaqësuar nga makja dhe shibljaku, pyjet e dushkut dhe pyjet e pishave të futura artificialisht.

Shkurret mesdhetare – areali me makje shtrihet në formën e një brezi të plotë në të gjithë anën perëndimore e jugore të parkut . Lloje të makjes përmendim xina, marja, mërsina, ilqja, shqopa etj.

Mareja (Arbutus unedo) është shoqëruar dhe me bimësi tjetër.

Shqopa (Erica arborea) gjendet në këto zone si bime e rendeishme dhe rrënjët e kësaj bime janë shumë të kërkuar në tregun vendas dhe të huaj.

Gjëneshtra (Spartium junceum) gjendet kudo në territoret kodrinore, përdorej nga banorët vendas për punimin e shportave dhe koshave për nevojat e tyre në bujqësi. Këto punime artizanale me gjëneshtra vitet e fundit po kërkojnë nga të huajt që vlerësojnë punën e dorës.

Dëllinja (Juniperus oxycedrus) me përhapje të zakonshme, frutat e saj janë me vlera ekonomike pasi kanë efekte shëruese për sëmundje të ndryshme dhe mund të përdoren dhe për prodhimin e rakisë.

Dafina e egër (Laurus nobilis) gjendet në kodrat më të larta të kësaj zone dhe ka vlera mjekësore. Shkurret gjetherënëse përfaqësohen nga bungbuta në trajtë shkurreje, shkoza e zëzë të shoqëruara nga frashëri i bardhë në disa areale gjendet dhe shega e egër.

Pyjet e pishave - përfaqësohen kryesisht nga blloqe të shumta përgjatë bregdetit dhe lagunes Pas dëmtimit në vitet e para të tranzicionit ky pyll sot ruhet në gjendje të mirë si një pasuri e çmuar për banorët e zonës.

Për t’u përmendur në bimësinë drusore është dhe prania e biotopeve të mirëfillta si shelgji shtet, vërrinjtë, plepat, dhe vidhat buzë lumenjve bazeneve ujore, përrenjve, kanaleve vaditë se, burimeve e rezervuareve të ujit..

Mbulesa bimore dhe në veçanti grumbujt pyjor përbëjnë një potencial natyror të rëndësishëm për një zhvillim të qëndrueshëm të hapësirës në studim.

Vitet e fundit pylli po rigjenerohet duke dhënë premisat e një zhvillimi të qëndrueshëm të ekonomisë pyjore dhe një mbështetje për turizmin e zonës (ky pyll mund të afrojë turizëm të gjelbër, turizëm aventurier, turizëm për piknik, turizëm për gjueti etj).

“ANGERBA” shpk



**OBJEKTI : “RIKONSTRUKSION DHE ASFALTIM I RRUGES SE FSHATIT GURRE, NJESIA ADMINISTRATIVE QUKES”
BASHKIA PRRENJAS**

“ANGERBA” shpk



**OBJEKTI : “RIKONSTRUKSION DHE ASFALTIM I RRUGES SE FSHATIT GURRE, NJESIA ADMINISTRATIVE QUKES”
BASHKIA PRRENJAS**

3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE, NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË TIJ

Lumi i Shkumbinit

Lumi Shkumbin, ose Lumi Shkëmbi, buron në malin e Valamares dhe duke rrjedhur nëpër një luginë të ngushtë e reliev të thyer derdhet në Detin Adriatik. Gjatësia e këtij lumi është 181 km ndërsa prurja e ujit arrin vlerën mesatare vjetore prej 61 m³/s.

Shkumbini është një ndër lumenjtë më të rëndësishëm për ekonominë shqiptare dhe që ndanë pothuajse në dy pjesë të barabarta Shqipërinë.

Lumi Shkumbin kalon nëpër krahinën e Mokrës në rrethin e Pogradecit. Lugina e Shkumbinit ka një bukuri të rrallë me katarakte, shpella, plazhe të vogla, etj. Përgjatë lumit në krahinën e Mokrës ka edhe mjaft vende të përshtatshme për peshkim dhe vende të tjera piktoreske që mund të vizitohen si Selca e Poshtme në Krahinën e Mokrës me një vendbanim Ilir të lashtë ura e Golikut në fshatin Golik atje ku bashkohen tre degë të lumit Shkumbin, etj. Më pas Lumi kalon nëpër rrethin e Librazhdit.

Rrjedha e lumit vazhdon në Rrethin e Elbasanit ku kalon shumë pranë qytetit të Elbasanit dhe më pas vazhdon në Peqin e Rrogozhinë deri sa derdhet në Detin Adriatik.

Lumi Shkumbin luan një rol të madh në jetën e banorëve të luginës së tij. Përgjatë lumit janë ngritur shumë vendbanime që i kanë përdorur burimet e lumit në aktivitete të jetës së përditshme. Mbi të janë ngritur vepra hidrike që përdoren për ujitje në bujqësi si p.sh.: Kanali "Naum Panxhi" në Elbasan që përdoret për vaditjen e fushës pjellore të Cërrikut dhe së fundmi në degët e tij janë projektuar edhe hidrocentrale të vegjël. Lumi i Shkumbinit e ka grykëderdhjen në Plazhin e Vilë - Bashtovës.

4. INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TË MUNDSHME, NEGATIVE, NË MJEDIS, TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR

Ndikimet në biodiversitet

Ndikimet negative të shkaktuara në biodiversitet nga dridhjet, pluhurat dhe zhurmat kanë vetëm rrugë reduktimi siç është përcaktuar në uljen e niveleve të tyre për ajrin dhe ujin. Përsa i përket humbjes së biomasës në territorin që do të shfrytëzohet, habitateve të fragmentizuara do të ndjehet disi sepse do të priten të gjitha bimët dhe pemët që padrejtesisht janë lejuar në trupin e argjinaturës. Por sipërfaqet e gjelbëruara jashtë trupit të argjinaturës janë të mjaftueshme gjë e

cila garanton diellzimin e nevojshëm dhe nxitjen e zhvillimit të specieve të tjera spontane. Në këtë mënyrë mund të sigurohet një vazhdimësi natyrore e vegjetacionit në zonat përreth. Rritja e vegjetacionit autokton do të nxisë edhe afrimin e faunës së përshtatshme për këtë vegjetacion, çka përputhet me faunën autoktone të zonës.

Ndikimet ne uje

Derdhja e ujrave të larjes apo i mbeturinave të lubrifikanteve të motorrave, gjate periudhes te zbatimit te punimeve mund të krijojnë kushte për ndikime të tjera, objekt i të cilave të jetë uji nëntokësor. Ndikimi i këtyre faktorëve është ”i vogël”, duke marrë në konsideratë nivelin e pajisjeve të përfshira dhe standartet me të cilat duhet të punojnë këto tip pajisjesh. Masat zbutëse përfshijnë “Praktikat më të Mira të Menaxhimit të Ndërtimit”, të cilat do të jenë një nga këkesat bazë të specifikimeve të kontratës.

Ndikimet ne toke

Gjatë periudhës së ndërtimit do të ketë dy burime mbeturinash:

- Materiali mbushjes për të realizuar infrastrukturën e parashikuar në tokë;
- Materiali i tepërt që do të rezultojë nga sheshimet apo nivelimet e ndryshme në zonën e shërbimeve.

Gjatë periudhës së funksionimit, problemi i prodhimit të mbeturinave do të jetë aq i rëndësishëm sa në periudhën e ndërtimit, sepse do të prodhohen mbeturina nga vetë proceset e punës. Pritet një prodhim jo i vogël i mbeturinave nga aktivitetet e shërbimit. Pritet gjithashtu, prodhimi i një sasive të madhe edhe të mbeturinave personale të punëtorëve dhe personelit. Llojet, sasi, data dhe mënyra e largimit të të gjithë mbeturinave të rëndësishme do të shënohet në një regjistër dhe për më tepër punëtorëve do t’u kërkohet të mbledhin veç fraksionet e ndryshme të mbeturinave.

Ndikimet ne ajer

Pluhurat që dalin nga proceset e ndërtimit, si dhe shkarkimi i gazrave të makinave janë burimet e mundëshme të ndotjes së ajrit, të cilat mund të rrisin përqëndrimin e materialeve të imta në të. Pjesa më e madhe e pajisjeve do të operojë në një ambient të hapur, me një dispersion të madh, për shkak të rrymave dhe erërave. Ndikimi në ndotjen e ajrit, pra mund të konsiderohet i lartë.

Standartet e cilësisë së ajrit dhe shkarkimet ndotëse në mjedis

Autoriteti	Vlerat mesatare të elementeve ndotës						
	SO ₂			NO _x			
	Vjetore	24h MAX	Ditore	Vjetore	24h MAX	Ditore	Orare
BANKA BOTERORE	0.1	0.5 (jashtë)	1 (brënda)	0.05 ppm	-	0.05	-
SHBA	0.02ppm waç	0.1ppm waç	-	0.05	-	-	-
	0,03ppm wbç	0.14 wbç		ppm			
		0.5ppm wacç					
WHO	-	90µg/m ₃	-	-	-	-	190-320 µg/m ₃
EU	80 µg/m ₃	-	-	200 µg/m ₃	-	-	-

Ndotja e ajrit nga grimcat e ngurta

Rrugët ndihmëse të furnizimit me lëndë do të trajtohen vazhdimisht me ujë përpara se të kalojnë automjetet, duke evituar kështu gjenerimin e pluhurave.

Efektet e dëmshme të ajrit të ndotur

Elementet që gjenden në ajër ushtrojnë efekte negative në shëndetin e njeriut. Këto efekte manifestohen në forma të ndryshme, që fillojnë me shqetësime në frymëmarrje, vazhdojnë me sëmundje kronike profesionale dhe arrijnë deri në intoksikacione të rënda, madje deri në vdekje. Aktualisht, studiuesit ndjekin pikërisht këto efekte, që vijnë si pasojë e ekspozimit për një kohë të gjatë me substanca ndotëse të veçanta ose të përziera. Organet e para që preken nga këto ndikime janë organet e frymëmarrjes. Ajri që thithet nga njeriu hyn në kontakt me gjakun dhe përhapet në gjithë trupin.

Efektet e dëmshme të gazeve

Veprimi i dëmshëm i gazeve ushtrohet kryesisht në rrugët e frymëmarrjes. Shpesh, ai vepron në kombinim me grimcat e ngurta. Gazet, në pjesën më të madhe të rasteve kanë veçoritë e tyre karakteristike, në mekanizmin e veprimit në organizëm. Ndërmjet gazeve, që ndotin atmosferën mund të përmendim CO₂, CO, SO₂, SO₃, H₂S etj. Këto japin efekte të dëmshme në rrugët e sipërme të frymëmarrjes, për shkak të tretshmërisë së tyre. Gazet, që kanë në përbërje azotin ushtrojnë veprim toksik në rrugët e thella të frymëmarrjes. Efektet patologjike të gazeve shfaqen në këto sëmundje:

- bronkiti kronik;
- asma bronkiale;
- sëmundje frymemarrjeje

Nga studimet e kryera mbi popullsinë e zonave të ndotura është vënë re rritje e sëmundshmërisë me kalimin e kohës. Këtu mund të përmendim pneumoninë, bronkitin, tuberkulozin dhe sidomos, ato të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes, siç janë rihinite, faringite, otite etj.

Duke patur parasysh që ndotja e ajrit është prezente duhet të ndërmeren masa të ndryshne praktike për të ulur ndikimin negativ, që ato kanë në rrugët e frymëmarrjes.

5. NJË PËRSHKRIM PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMA, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE;

Ujrat e ndotura

Derdhja e ujrave të larjes apo i mbeturinave të lubrifikanteve të motorrave, mund të krijojnë kushte për ndikime të tjera, objekt i të cilave të jetë uji nëntokësor. Ndikimi i këtyre faktorëve është ”i vogël”, duke marrë në konsideratë nivelin e pajisjeve të përfshira dhe standartet me të cilat duhet të punojnë këto tip pajisjesh. Masat zbutëse përfshijnë “Praktikat më të Mira të Menaxhimit të Ndërtimit”, të cilat do të jenë një nga këkesat bazë të specifikimeve të kontratës.

Pluhur dhe gazra

Pluhurat që dalin nga proceset e ndërtimit, si dhe shkarkimi i gazrave të makinave janë burimet e mundëshme të ndotjes së ajrit, të cilat mund të rrisin përqëndrimin e materialeve të imta në të. Pjesa më e madhe e pajisjeve do të operojë në një ambjent të hapur, me një dispersion të madh, për shkak të rrymave dhe erërave. Ndikimi në ndotjen e ajrit, pra mund të konsiderohet i lartë. Rrugët ndihmëse të furnizimit me lëndë do të trajtohen vazhdimisht me ujë përpara se të kalojnë automjetet, duke evituar kështu gjenerimin e pluhurave.

Elementet që gjenden në ajër ushtrojnë efekte negative në shëndetin e njeriut. Këto efekte manifestohen në forma të ndryshme, që fillojnë me shqetësime në frymëmarrje, vazhdojnë me sëmundje kronike profesionale dhe arrijnë deri në intoksikacione të rënda, madje deri në vdekje. Aktualisht, studiuesit ndjekin pikërisht këto efekte, që vijnë si pasojë e ekspozimit për një kohë të gjatë me substanca ndotëse të veçanta ose të përziera. Organet e para që preken nga këto ndikime janë organet e frymëmarrjes. Ajri që thithet nga njeriu hyn në kontakt me gjakun dhe përhapet në gjithë trupin.

Nga studimet e kryera mbi popullsinë e zonave të ndotura është vënë re rritje e sëmundshmërisë me kalimin e kohës. Këtu mund të përmendim pneumoninë, bronkitin, tuberkulozin dhe sidomos, ato të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes, siç janë rihinite, faringite, otite etj.

Duke patur parasysh që ndotja e ajrit është prezente duhet të ndërmeren masa të ndryshme praktike për të ulur ndikimin negativ, që ato kanë në rrugët e frymëmarrjes.

Zhurmat dhe dridhjet

Zhurma nga aktivitetet e ndërtimit mund të jetë e rëndësishme për një periudhë të kufizuar kohe. Nivelet e zhurmës të shkaktuara nga aktivitetet e ndërtimit mund të ndryshojnë shumë, në varësi të fazës së ndërtimit dhe detyrës specifike, që po kryhet. Të gjitha pajisjet që lëshojnë zhurmë do të mirëmbahen ashtu siç duhet për të minimizuar ndikimin e zhurmës në rajon. Pajisjet që lëshojnë zhurmë do të jenë sipas standarteve të BE rreth zhurmës së shkaktuar në mjedis. Gjatë periudhës së ndërtimit, zhurma që do të gjenerohet do të jetë e neglizhueshme. Burimet e vetme të mundshme do të jenë motorët e pompave, por ata do të vendosen në vendet të mbyllura dhe të izoluara. Në vijim paraqiten nivelet maksimale të zhurmës, që pranohet.

- E vazhdueshme 1.000m nga kompleksi 45dBA;
- E çastit 1.000m nga kompleksi 55dBA;
- Niveli maksimal 1m nga pajisja 85dBA.

Prodhimet e mbetjeve

Gjatë periudhës së ndërtimit do të ketë dy burime mbeturinash:

- Materiali mbushjes për të realizuar infrastrukturën e parashikuar në tokë;
- Materiali i tepërt që do të rezultojë nga sheshimet apo nivelimet e ndryshme në zonën e shërbimeve.

Gjatë periudhës së funksionimit, problemi i prodhimit të mbeturinave do të jetë aq i rëndësishëm sa në periudhën e ndërtimit, sepse do të prodhohen mbeturina nga vetë proceset e punës. Pritet një prodhim jo i vogël i mbeturinave nga aktivitetet e shërbimit. Pritet gjithashtu, prodhimi i një sasive të madhe edhe të mbeturinave personale të punëtorëve dhe personelit. Llojet, sasive, data dhe mënyra e largimit të të gjithë mbeturinave të rëndësishme do të shënohet në një regjistër dhe për më tepër punëtorëve do t’u kërkohet të mbledhin veç fraksionet e ndryshme të mbeturinave.

Pershkrimi i Pergjithshem i Punimeve qe do te kryhen :

1.Punime ne shtresat rrugore :

Nga piketa 1 deri ne piketen 118 me gjatesi 1 440 ml do te kete:

-Shtrese cakelli 20 cm, per te krijuar kushte per shtresen e stabilizantit.

Nga piketa 118 deri ne piketen 133 me gjatesi 235 ml do te kete :

- Shtrese cakelli 2x20 cm, per te krijuar kushte per shtresen e stabilizantit
- Shtrese stabilizanti 10 cm, per te krijuar kushte per shtresen e binderit.
- Sperkatje me 2kg per m² me bitum
- Shtrese binderi 6cm, si shtrese lidhese ndermjet stabilizantit dhe asfaltobetonit.
- Sperkatje me 0.5 kg per m² me bitum.
- Asfaltobeton 4cm.

Gjeresia e rruges eshte zgjedhur e tille qe ti pershtatet gjendjes faktike te rruges egzistuese. Kjo gjeresi eshte 4.5 m perfshire dhe dy bankina anesore te rruges me gjeresi 0.5 m secila.

Projekti ka parashikuar ne segmentet me pjerresi gjatesore mbi 15%, ne piketat 75 deri 84 dhe 91 deri 106 me gjatesi totale 490 m, shtresat asfaltike te zevendesohen me beton arme. Shtresa e stabilizantit t = 10 cm do te zevendesohet me shtrese zhavorri t = 10 cm. Betoni do te jete C 16/20 i shoqeruar me zgare hekuri Ø 8 mm i vendosur ne kuadrate 10 x10 cm.

Projekti parashikon vijeimin e rruges me vije te bardhe t = 12 cm ne te dy anet e saj ne te gjithë gjatesine.

Eshte parashikuar dhe sinjalistike mbrojtese duke vendosur Guard Rail N2 anesore me dy valezime ne nje ane ,W4 ne nje gjatesi prej 350 m.

Eshte parashikuar gjithashtu krijimi i vendnderrimeve per makina e kamione.Po ashtu eshte parashikuar dhe shtrimi i rrugicave te lagjeve dhe banesave me nje gjatesi prej 5 m.

2.Disiplinimi i ujrave te bardha

Bazuar ne studimin hidrologjik dhe ne llogaritjet hidraulike eshte percaktuar siperfaqja e domosdoshme e tubacionit rrethor per gjithë gjatesine e rruges.

Per te disiplinuar ujrat do te ndertohen tre tombino me Ø 600 mm dhe gjatesi 5 ml ne piketat 37, 59 dhe 118.Do te ndertohet nje tombino me Ø 400 mm dhe gjatesi 12 ml ne kanalin anesor te rruges ne Pk. 89. Do te behet zgjatja e tombinos egzistuese me Ø 1000 mm dhe gjatesi 2 ml ne Pk.5.

Eshte parashikuar ndertimi i 25 kalimeve me tub celiku Ø 200 mm prej te cileve 24 cope me L = 5 ml secili.Ndersa 1 cope me gjatesi 12 m. 10 prej tyre jane per ti sherbyer kanaleve ujtesese per nderprerjen e rruges ndersa 15 te tjerat jane per ti sherbyer kanaleve anesore te rruges ne kryqezimet e saj me rruget lidhese.

Eshte parashikuar ndertimi i kanalit anesor te rruges me beton 16/20 ne forme lugu ne segmentin Pk.99-106 me gjatesi 104 ml.Ky kanal do te sherbeje si kanak ujites gjate sezonit te veres dhe si kanal per kullimin e ujrave ne sezonet e tjera gjate vitit.

Grupi i projektimit eshte i gatshem te bashkepunoje per ndonje ndryshim te mundeshem qe kushtezohet nga koha e zbatimit te ketij projekti.

6. INFORMACION PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA;

Ndikimet estetike që rezultojnë nga ndërtimi dhe materiali i gërmuar konsiderohen si të neglizhueshme. Në zonat e ndërtimit në rajon, ka operacione, si ngarkim-shkarkim, lëvizja e materialeve, operacionet e karburanteve, për të cilat nuk pritet të rezultojnë në ndonjë shqetësim të dukshëm estetik, vetëm se pritet të jenë të pranishme gjatë operacioneve ndërtimore.

Cënimi i interesave publike ose private

Cënimi i interesave publike apo private dhe interferenca në përdorimin publik nuk konsiderohet një ndikim domethënës i fuqishëm. Ndërtimet e propozuara do të kryhen me konsideratën e minimizimit të të gjitha çënimeve të interesave publike apo private.

Ndikimi në burimet arkeologjike dhe kulturore

Ndikimi në burimet kulturore dhe arkeologjike, që rrjedh nga operacionet e gërmimit dhe depozitimit nuk pritet që të ndodh. Nuk ka vende arkeologjike dhe kulturore, qoftë në vendin e gërmimit, ashtu dhe në atë të depozitimit apo reklamimit të tokës.

Ndryshimet tokësore

Këto veprimtari përfshijnë përmirësimin e aksesit në sheshet e ndërtimit, përgatitjen e shesheve të ndërtimit, kullimin e shesheve, punimet e themeleve, largimin e mbeturinave, ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve, udhëtimet e punëtorëve dhe veprimtari të tjera të nevojshme për t'u kryer.

Dukuritë që do të ndodhin gjatë ndërtimeve

Proçesi i ndërtimit do të jetë një nga zërat më voluminozë dhe me kohëzgjatje jo të madhe. Është më se e natyrshme që gjatë kësaj periudhe do të ketë një sërë ndikimesh në mjedis, që mendojmë se është e udhës të merren në konsideratë.

Zona në vazhdimësi duhet trajtuar me kujdes, duke pasur parasysh edhe vlerësimet e bëra më lart dhe në përputhje të plotë me planet zhvillimore për një zhvillim të qëndrueshëm të saj.

Problemet kryesore mjedisore, që potencialisht mund të lindin gjatë funksionimit të tij do të jenë :

1.- Prodhimi i pluhurave

Gjate punes per ndertimin e ketij objekti krijohen pluhura te ndryshem, por sasia e tyre eshte e pa perfilleshme.

2.- Krijimi i zhurmave

Si rezultat i përdorimit të paisjeve të shërbimeve, krijohen zhurma të ndryshme.

3.- Krijimi i mbeturinave nga shërbimet

Gjate proceseve të ndryshme të shërbimeve krijohen mbeturina të karaktereve të ndryshme

7. TË DHENA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPESINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NE MJEDIS, QE NENKUPTON DISTANCEN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QE PERFSHIHEN NE TE

Zhurmat gjatë ditës dhe ndikimet vizuale (p.sh. lëvizja e automjeteve dhe të njerëzve) si edhe ndikimet e ndricimit nga dritat e automjeteve (nese do punohet) gjatë natës mund të ulin mundësinë e përshtatshmërisë për gjitarët apo shpendët që mund të ndodhen në afërsi të sheshit që do punohet. Këto ndikime do të jenë të larta për zonën ngjitur me rrugën dhe më të ulta larg saj. Të gjitha këto ndikime do të ulin numrin e gjitarëve apo shpendëve në zonat pranë sheshit të punimeve. Ndikimi tjetër është sepse mbyllja e korridoreve natyrore do të sjell aksidente dhe demtime të gjitarëve që do të përpiqen të kalojnë rrugën.

Kohëzgjatje e ndikimeve

Ndikimet vizuale (lëvizja e automjeteve dhe të njerëzve) do të jenë të theksuara gjatë ditës. Ndikimet në specie të tilla si shpendë dhe gjitarëve do të jetë më të madh gjatë sezonit të shtimit.

Një sere ndikimesh të rëndësishme të vazhdueshme janë parashikuar nga ndotja aksidentale të tilla si çlirimi i hidrokarbureve dhe rrjedhje të tjera në habitatet ujore. Ndotje aksidentale mund të jetë shumë e dëmshme për mjedisin ujor. Ndotja aksidentale zakonisht është e kthyeshme me masa të përshtatshme kohë dhe në varësi nga shkalla e ndotjes.

Kohezgjatja

Ndikimet mund të ndodhin gjatë gjithë jetës së këtij kantieri, pra 5 muaj sipas grafikut të punimeve.

Kthyeshmëria

Efektet e ndotjes dhe çrregullimeve fizike në faunë janë të kthyeshëm brenda një periudhe normale edhe pse kjo do të varet nga lëvizshmërinë e faunës në zonat ujore të prekura. Ajo ka tendencë të jetë afatgjatë, vetëm kur ndodh një ndotje e cila çon në reduktime afatgjatë të biodiversitetit në ujra rrethore egzistues. Një ngjarje diskrete ndotjes, gjithsesi mund të ketë pasoja të rënda në drejtim të rrymës nga vendin e ndotjes.

Koha dhe Frekuenca

Ndikimet e ndotjes mund të ndodhin në çdo kohë. Rreziku i i ndotjes nga trafiku për faunën do të jetë më e lartë gjatë sezonit të shtimit. Gjatë funksionimit të këtij objekti , shetitore mbi , mund të ketë ndikime të rëndësishme në faunën ujore si rrjedhojë e ndotjes aksidentale dhe nga rritja e rrezikut të përplasjes.

Forca dhe shtrirja në kohë e ndikimit

Objekti i propozuar do te sjelle nje levizshmeri te madhe si persa i perket shtimit te numrit te automjeteve qarkulluese ne rrugen ekzistuese ashtu edhe shtimit te numrit te personave qe do frekuentojne keto zona. Zbatimi i një skeme që do ti orientonte kafshët drejt nje lidhje korridoresh natyrore më mënyra të tjera do të minimizonte rrezikun dhe do të ulte numrin e kafshëve të vrara si edhe do të përmirësonte kushtet e sigurisë dhe shëndetit për përdoruesit e këtij ambjenti shetitor dhe sodites.

Individët mund të zëvendësohen nëpërmjet proceseve natyrore të shtimit dhe të shpërndarjes

Ndikimet do të jenë më te larta gjatë sezonit të shtimit kur gjitarët janë shumë aktiv dhe gjithashtu në vjeshtë kur bimësia të jetë zverdhur dhe gjitarët kanë nevojë për tu shpërndarë në territore të reja. Duke pasur parasysh faktin që këto janë të kafshë mëdha, specie të lëvizshme të cilat kërkojnë korridore të pandërprerë të cilat do të fragmentizohen si pasojë e perdorimit te objektit të propozuar ne te gjitha stinet, është konsideruar se ndikimi mbi gjitarët nuk do të jetë i madh.

8. MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR TË SIPËRFAQES NË GJENDJEN E MËPARSHME, SI DHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN;

Plani i Monitorimit Mjedisor

Monitorimi do të verifikojë nëse ndikimet e parashikuara kanë ndodhur në të vërtetë dhe kontrolloje nese veprime zbutëse të rekomanduara në VNM janë zbatuar dhe cili ka qene efektiviteti i tyre. Monitorimi do të identifikojë edhe ndikimet e paparashikuara që mund të lindin nga zbatimi i projektit.

Kush monitoron dhe si: Monitorimi do të kryhet nga Bashkia Prrenjash dhe Inspektorët e Mjedisit të Agjencise Rajonale te Mjedisit (ARM) qe përfaqësojnë AKM Monitorimi nga ARM-ja në këtë rast mund të konsiderohet si "Monitorim nga një palë e tretë", por ky është mandati i saj rregullator në përputhje me VKM Nr 47, datë 29.01.2014 "Për përcaktimin e rregullores për

organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit"

Një agjenci qeveritare që mund të ndërmarrë "Monitorimin nga një palë e tretë" është Inspektorati Shtetëror i Punës. Kjo njësi ka autoritetin për të inspektuar çdo strukturë për zbatimin e ligjshmërisë për sigurinë në vendet e punës.

Monitorimi do të bëhet me anë të inspektimit, shqyrtimit të ankesave të regjistruara nga palët e interesuara dhe diskutime ad hoc me persona potencialisht të prekur (punëtorët e ndërtimit, banorët pranë zones së projektit, etj.).

Frekuenca: Monitorimi do të kryhet çdo muaj gjatë gjithë periudhës së ndërhyrjes.

Auditimet: Auditimet do të jenë të nevojshme si gjatë ndërtimit ashtu edhe gjatë funksionimit të projektit. Ndërsa auditimet e ndërtimit do të synojnë në verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat për masat zbutëse të ndikimit, auditimet post-ndërtimit janë një kërkesë ligjore dhe duhet të kryhen si rregull brenda 12 muajve por jo më vonë se 36 muaj pas përfundimit të ndërtimit.

Si auditimi gjatë ndërtimit ashtu dhe ai post-ndërtim mund të jenë të brendshëm (kryhen nga Bashkia Prrrenjas) ose të jashtëm (nga një konsulent i angazhuar nga Bashkia). Në këtë PMM është propozuar edhe buxheti përkatës, nëse auditimi do të kryhet nga një konsulent i punësuar për këtë qëllim.

Raportimi: Bashkia Prrrenjas duhet të hartojë çdo muaj raporte mbi monitorimin. Keto raporte duhet ndahen me palët e interesuara. Bashkia mund të ndajë raportet e saj të auditimit gjatë fazës së ndërtimit dhe post-ndërtimit me AKM apo aktorë të tjerë të interesuar por nuk ka asnjë detyrim të bëjë të ditur auditimet në fazën e ndërtimit.

Te Pergjithshme

Mbrojtja e mjedisit është një detyrë që duhet të zgjidhet që në hartimin e projekt zbatimit të aktivitetit. Ky projekt në skemën e tij duhet të përmbajë elemente, që sigurojnë marrjen e masave në rast anomalie apo avarish, që mund të jenë deri në dëmtues të lëndës së parë apo rënie zjarri. Hartimi i projektit të cekët apo me mangësi, zbatimi i punimeve me cilësi të dobët që bëhen burim avarish, janë shkaqet që sjellin pasoja të rënda në mjedis.

Plani i zbutjes së ndikimeve negative dhe rehabilitimet

Masat paraprake për zbutjen e rreziqeve

Për uljen e rrezikut të aksidentimit të banorëve nga mjetet e objekteve që do të ndërtohen në zonë, duhet të pajiset me tabela treguese të shpejtësisë së mjeteve deri në 20 km/orë. Për evitimin e bllokimit të rrugës nga pamundësia e kalimit të dy mjeteve njëkohësisht në drejtime të

kundërta, duhet të krijohen zgjerime në formë xhepush, në frekuenca të mundëshme dhe të aprovuara nga autoritetet. Në rastet kur nuk është identifikuar asnjë masë zbutëse ose kur ndikimi nuk mund të zbutet siç duhet, VNM-ja ka trajtuar ndikimet e mbetura ose “reziduale”. Ndikimet reziduale shqyrtohen për secilin aspekt mjedisor dhe për nivelin e tyre të identifikimit.

Ulja e intensitetit të ndotjes së ajrit

Më lart u argumentua se veprat urbane do të gjenerojnë ndotje të ajrit në fazën e ndërtimit, por do të ketë ndërhyrje për minimizimin e saj.

Ulja e intensitetit të ndotjes së zhurmave

Lëvizja e automjeteve e përqëndruar në një interval dite kohor janë një burim zhurme, por me kohëzgjatje të rendit të milisekondave. Nivelet e zhurmës së krijuar nga lëvizja e automjeteve me llogari teorike mbërrijnë në fshat me vlera rreth 40-50 dB(a), por jo më të mëdha. Në rastin e punëtorëve të këtij aktiviteti, kjo zhurmë i kalon kufijtë e lejueshme të ekspozimit profesional prej 65dB(a) për 8 orë ekspozim të vazhdueshëm gjatë javës 40 orëshe të punës. Lëvizja e shpejtë e makinave për uljen e ekspozimit ndaj zhurmave në njësi kohe nuk mund të realizohet, për shkak të rritjes së riskut për aksidente dhe gjenerimit më të madh të pluhurave edhe në rast se rruga është e asfaltuar. Pra, niveli i zhurmave të këtyre mjeteve në rrugën pranë saj llogaritet në vlerat 75-85dB(a). Për shkak se në rrugën në fjalë edhe përpara projektit kalojnë mjaft automjete, zhurmat e krijuara nga automjetet për furnizim me mall nuk përbën një problem të ri për zonën.

Ulja e ndikimit të ndotjes së ujërave sipërfaqësore

Ndotja e ujërave sipërfaqësore pritet të ndodh kryesisht nga shpëlarja e ambjentit përreth, ku këto ujra do të derdhen në një kanal. Për këtë do të merren disa masa zbutëse për rehabilitimin e këtyre ujërave. Në këtë kanal do të maten nivelet e ndotësve prej vajrave, duke normalizuar në nivelet e ujërave industrial dhe në këtë moment ato derdhen pa problem në lume. Siç është përmendur më lart, gjatë procesit të ndërtimit çlirohen gjithashtu tymra djegjes si; COV, NOX, CO, SOX, PM10. Në tabelën e mëposhtme jepen pajisjet e ndërtimit të standarteve që do të përdoren si sasi të gazrave që këto pajisje potencialisht shkarkojnë në atmosferën, ku punojnë. Është plotësisht e mundur të vlerësohet numri dhe tipi i pajisjeve, që do të përfshihen në realizimin praktik, duke u bazuar në publikime të ndryshme dhe në zgjatjen e periudhës së përdorimit.

Disa masa zbutëse për zvogëlimin e ndikimeve në reduktimin e çlirimeve të fazës së ndërtimit

<i>Masa zbutëse</i>	<i>Frytshmëria</i>
Realizimi sa më shpejt që të jetë e mundur i shtrimit të rrugëve të brendëshme	70%
Larja e rrugëve të pista dhe të shesheve të ekspozuara të ndërtimit gjatë stinës së thatë	60%
Ujitja e grumbujve të inerteve në mënyrë periodike	60%
Përdorimi i hinkave për shkarkimin e matrialeve	65%
Kufizimi i shpejtësisë së mjeteve të rënda	Sipas fazës

Këto çlirime dhe ndikimet e tyre mund të konsiderohen të neglizhueshme, duke pasur parasysh kohëzgjatjen e kufizuar të fazës së ndërtimit.

Të dhëna mbi çlirimin e gazeve nga makineritë e ndërtimit

Pajisja	CO wgh ⁻¹ ç	COV wgh ⁻¹ ç	NO _x wgh ⁻¹ ç	Soxwgh ⁻¹ ç	Dust wgh ⁻¹ ç
Makinë shtrimi, Eskavatorë dhe buldozier me rrota gome, Ekskavatorë të vegjël me rrota	259.58	113.17	858.19	858.19	
Autobetoniere, Rul, Autovinç, Kamion, Traktor me rrota gome Autobot	816.81	86.84	1889.1	206	116
Vinç, Grup gjeneratori, Kompresor ajri, Saldatriçe, Çekiç pilotash	306.37	69.35	767.3	64.7	63.2

Ulja e ndikimeve negative në biodiversitet

Për të zbutur humbjen e biomasës në territorin që do të shfrytëzohet, habitateve të fragmentizuara do të merren masat si më poshtë:

- Së pari do të bëhet mbjellja në zona me metodën e mulçirimit, që është e njohur nga punonjësit e shërbimit pyjor në rrethe. Në këtë mënyrë mund të sigurohet një vazhdimësi natyrore e vegjetacionit në zonat përreth.
- Pas mbjelljes, fidanët për një periudhë 2 vjeçare do të ruhen (mbrohen) nga Bashkia Prrenjas, prej kullotjes.
- Rritja e vegjetacionit autokton do të nxisë edhe afrimin e faunës së përshtatshme për këtë vegjetacion, çka përputhet me faunën autoktone të zonës.

Ulja e intensitetit të erozionit dhe zbutja e ndryshimit të topografisë

Si masat zbutëse kundër erozionit të mundshëm të formuar në rrugët e hapura për komunikim me objektet që do të ndërtohen janë dy nivelet bazë, masa hidroteknike dhe biologjike duke realizuar:

- Mbajtjen e brezave me sipërfaqe, me gjelbërim të përhershëm jashtë dhe brenda objekteve dhe mbjelljen e pemëve halore të natyrës së mjedisit;

Masat zbutëse gjatë periudhës së ndërtimit

Masat për uljen dhe kontrollin e çlirimeve gjatë fazës së operimit janë përshkruar në tabelën e mëposhtme. Këto përfshijnë:

- Minimizimin e ngarkësës
- Përmbajtjen
- Rekuperimin apo Riciklimin
- Pakësimin e çlirimeve
- Trajtimin dhe largimin e mbeturinave.

Bashkia Prrenjas do të jetë përgjegjës drejtpërsëdrejti për shfrytëzimin korrekt të objektit sipas Legjislacionit Shqiptar dhe standarteve ndërkombëtare të sigurisë të listuara dhe do të mbajë përgjegjësinë për zbatimin e masave të përmbledhura në tabelat e mëposhtme.

Masat zbutëse gjatë periudhës së ndërtimit

<i>Veprimtaria</i>	<i>Ndikimet e Mundshme</i>	<i>Masat zbutëse</i>
Menaxhimi i dherave të ndotura	Shqetësime të mundshme të shëndetit	Dheu i ndotur do të ruhet në mënyrë të sigurtë nën zonë të asfaltuar për të shmangur përhapjen e ndotësëve
Menaxhimi i mbeturinave industriale dhe inerte	Shqetësime të mundshme të shëndetit	Selektimi i mbeturinave urbane dhe pas largimi i tyre
Fuqia punëtore për veprim	Fluksi i puntorëve krijon trysni mbi banesat dhe trafikun	Fluksi i puntorëve do të jetë i ulët dhe pjesa dërrmuese e tyre do të jetojë në rajon
Furnizimi me ujë të pijshëm	Përkeqësim furnizimin me ujë të komunitetit	Përdorimi i ujit industrial nga burime të ndryshme nga ujësjellësi
Përfundimi i punimeve	Pamja estetike	Nivelim dhe gjelbërim i sipërfaqeve të lira të sheshit, si dhe të sheshit përfaq

Masat zbutëse të ndikimeve në mjedis gjatë periudhës së funksionimit Përmbledhja e vlerësimeve të ndikimeve në mjedis gjatë shfrytëzimit

<i>Parametri mjedisor</i>	<i>Burimi</i>	<i>Rëndësia e Përgjithshme</i>		
		<i>E (U)lët</i>	<i>E (M)oderuar</i>	<i>E (L)artë</i>
Ndotja e ujit	Ujra potencialisht të ndotura nga rrjedhja e “shpërlarjes së parë”	U		
Cilësia e ajrit	Çlirimet VOC	U		
	Pluhurat		M	
	Motorrat e pajisjeve		M	
Trafiku	Udhëtimet e kamioneve për ngarkimin e prodhimeve		M	
Mbeturinat e rrezikshme	Shkumrat e lagura nga impjanti ndarës naftë/ujë	U		
Mbeturinat e ngurta	Gjatë operimit	U		

Masat zbutëse gjatë periudhës së funksionimit

Aktiviteti	Ndikimet e Mundshme	Masat zbutëse
Lëvizjet e kamionave	Trafiku	Parashikimi i një grafiku lëvizjesh në orët e qarkullimit të pakët (natën mundësisht)
Për ngarkimin e prodhimeve	Çlirimet e tymrave dhe blözës së djegieve	Parashikimi i një grafiku lëvizjesh në orët e qarkullimit të pakët (natën mundësisht)
Derdhjet e rastit	Ndotja e mundëshme e ujit	Shtrimi me beton i baseneve të ruajtjes do të lejojë mbledhjen efektive të rastit në pusetat përkatëse dhe trajtimi i tyre sipas normave të parashikuara në projekt. Uji i ndotur me vaj do të trajtohet para se të derdhet në mjedis.
Menaxhimi i mbeturinave të lëngshme	Ndotja e mundëshme e mjedisit	Mbetjet e lëngëta do të riciklohen ose po të jetë e nevojshme do të depozitohet dhe do të nënshtrohet periodikisht trajtimit të përhershëm para se të derdhet.
Menaxhimi i mbeturinave të ngurta	Ndotja e mundëshme e mjedisit	Tipet, sasi, data dhe mënyra e largimit të të gjithë mbeturinave të rendësishme do të rregjistrohen dhe do të bëhen sipas tableës

Masat për uljen e efekteve negative

- Me karakter teknik;
- Me karakter organizativ;
- Kontrolli dhe monitorimi në kohë.

Ripërtëritja e mjedisit

Ndërtimi i strukturave do të behet duke mos cënuar bimësinë, që rritet aty dhe sipërfaqen e gjelbër. Për fat të mirë, në sektorët e propozuar, kulturat bujqësore të mbjella mungojnë plotësisht. Në marrëveshje të plotë me pronarët përkatës, sipas një plani që do të përmendet paksa më poshtë, sipërfaqet për qark objekteve do të sistemohen, duke marrë masa për ta ruajtur dhe mbrojtur nga erozioni. Ky plan përfshin:

- Minimimizimin e lëvizjes së dheut;
- Mbjelljen e barit dhe të pemëve mbi lartësinë e ndërtimeve në zonat, ku parashikohet erozioni;
- Ndalimin e dëmtimit të shkurreve, pemëve frutorë, pemëve pyje, aty pranë shesheve të ndërtimeve;
- Ndalimin e dëmtimit të bimësise së ulët e të lartë;
- Rekuperimin e saj trefish, aty ku mund të ketë ndonjë ndërhyrje të detyruar, etj.

Restaurimi dhe rehabilitimi i ndikimeve ndaj mjedisit do të kryhet si një domosdoshmëri në kthimin e pasurive të vlerësuara në kushtet e mëparshme, sa më mirë që të jetë e mundur. Kjo do të jetë e mundur, sepse vetë Operatori, si dhe studimi i linjës së bazë të ndikimeve në mjedis, që po paraqet, kanë identifikuar ndikimet potenciale dhe masat që duhet marrë për parandalimin, minimimizimin dhe mënjanimin e ndikimit të tyre.

Problemet e vërejtura

- Mungesa e organeve përgjegjëse ligjore për hartimin e strategjive;
- Administrimi i mangët ligjor i territorit urban, (njohja e kthimi i pronave);
- Menaxhimi i mangët i mjedisit urban e i aktiviteteve të tjera për të mbështetur zhvillimet që respektojnë mjedisin;
- Ndërgjegjësimi i pakët i komunitetit për mbrojtjen e mjedisit;
- Mungesa e rrjetit informativ e ndërgjegjësues për mjedisin.

Studimi e aplikimi i projektit të impiantit të trajtimit të ujrave të zeza

- Kryerja e një plan veprimi për eliminimin e shumë pikave të shkarkimit;
- Ndërtimi jo vetëm i një impianti trajtimi sipas studimit teknik, por të disa impianteve) në bazë zone apo sektori.

Përmirësimi i krejt sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm

- Krijimi i degëzimeve të reja për lagje të reja e rikonstruksioni i rrjetit të vjetër.
- Shërbime në depo, klorinimi i rregullt, rritja e numrit të pikave të marrjes së mostrave për analizë.
- Zgjidhja teknike për realizimin e klorinimit për degëzimin për lagjet e reja.

Përcaktimi, ngritja e funksionimi efektiv i sistemit të largimit të mbeturinave urbane dhe hartimi i një plani veprimi e zbatimi i tij.

- Përcaktimi i pikave, kohës, frekuencës, llojit të automjetit për evadimin e mbeturinave dhe gjetja e vendit të përshtatshëm dhe burimeve financiare për këtë qëllim;
- Caktimi i ditëve për largimin e objekteve të ndryshme të vjetëruara nga banesat të nxjerra si mbetje;
- Ndërgjegjësimi i komunitetit për mbajtjen pastër të zonës së Bashkisë Prrenjas dhe aplikimi i gjobave.

Mbetjet urbane do të trajtohen integralisht, duke bërë një parcelë me formacion argjilor të caktuar ndarjen dhe përgatitjen si lëndë e parë për riciklimin, ripërdorimin dhe kompostimin.

Rehabilitimi i vatrave të ndotura nga shkarkimet e mbetjeve të ndryshme.

- Largimi i mbeturinave nga vatrat e ndotura;

Ky vend do të caktohet në një formacion përsëri argjilor së bashku me trajtimin e mbetjeve të ngurta urbane

Zbatimi dhe mundësimi i teknologjive e aktiviteteve ricikluese të mbetjeve

- Mundësimi i riciklimit të qelqit, letrës, metaleve, etj;
- Përgatitja dhe zbatimi i një plan veprimi për këtë qëllim.

Restaurimi dhe përmirësimi i habitatit dhe biodiversitetit

- Kryerja e studimit të gjeorrezikeve për zonën e “mbrojtur nga ndërtimet” dhe për zhvillimin e habitatit;
- Restaurimi me mbjellje dhe harmonizimi me objektet e tjera urbane;
- Përcaktimi i bimësisë dhe biodiversitetit që vendoset;
- Përgatitja dhe zhvillimi i planit të veprimit për këtë qëllim.

Përmirësimi i brezit të gjelbert me anë të masave sipas një plani veprimi.

- Përgatitja dhe zbatimi i një plan veprimi për ndalimin e kullotjes pa kriter ;
- Monitorimi i gjëndjes së pyjeve, inventarizimi dhe mbrojtja e tyre;
- Përcaktimi i zonave të gjelbërta, që nuk do të preken nga ndërtimet;
- Vënia në efikasitet të sistemit të gjobave.
- Plan veprimi për marrjen e masave për mbrojtjen nga rreziku nga rrjeti i amortizuar, kabinat e dëmtuara, ndërhyrjet e kundër ligjshme, etj.
- Promovimi i sistemeve lehtësuese e nxitja e aktiviteteve që bëjnë furnizimin me gaz të lëngët çon në uljen e përdorimit të energjisë elektrike

9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS;

Duke patur parasysh vlerat jo të mëdha të territorit në gjëndjen aktuale, mendohet se kompensimet dhe ndikimet e tjera pozitive, si punësimet, përmirësimet në infrastrukturë marrin një rëndësi të veçantë për komunitetin e rajonit. Këto ndikime nxisin edhe komunitetin për mbështetjen e investimeve.

Avaatazhet dhe disavantazhet e infrastrukturës aktuale të mjedisit të rajonit

AVANTAZHET	DISAVANTAZHET
<ul style="list-style-type: none"> • Vendndodhja - Vendndodhja në dhe pranë një rezervati natyror. - Ka potencial për zgjerimin e aktiviteteve të shlodhjes; • Administrimi i tokës dhe planifikimi i shfrytëzimit të saj; - Kërkesa e lartë për ndërtime të mëtejshme; - Kapaciteti rregullator, relativisht i fortë i rajonit në lidhje me mbrojtjen e hapësirave të gjelbërta; • Pronësia dhe regjistrimi i tokës - Konflikte të zgjidhura lidhur me të drejtat e pronësisë - Përqindja e lartë e pronës private, si bazë për motivim dhe zhvillim; - Prezencë e tokave publike - Prezencë objekteve publike 	<ul style="list-style-type: none"> • Administrimi dhe planifikimi i shfrytëzimit të tokës : - Shtrirja e paplanifikuar urbane; - Në aktivitetet ndërtimore nuk merren në konsideratë zonat e rreziqeve gjeologjike, tektonike e sizmike; - Kushtet e këqija të jetesës, për shkak të kanaleve të pamjaftueshme kulluese. - Humbja e tokave bujqësore, për shkak të aktiviteteve ndërtimore të pakontrolluara - Cilësia e dobët e planifikimit të shfrytëzimit të tokës; - Kapaciteti planifikues dhe zhvillues i rajonit i pamjaftueshëm; - Aktivitete të pa organizuara ndërtimore, si pasojë e zhvillimit spontan të tregëtisë; - Instrumenta të dobët për planifikimin dhe zbatimin e planeve; - Kapaciteti rregullator i ulët i shtetit; - Tokat janë të pakëta për zhvillimin e industrive të teknologjive të avancuara; - Nuk ka koordinim për zhvillim rajonal. • Pronësia dhe regjistrim i tokës: - Pronësia private si pengesë për administrimin e mirë të tokës

Avantazhet dhe dobësitë në lidhje me infrastrukturën teknike bashkiake

AVANTAZHET	DOBËSITË
<ul style="list-style-type: none"> • Furnizimi me ujë: <ul style="list-style-type: none"> - Aktivitete të realizuar në shtrirjen e sistemit të furnizimit me ujë - Personel i kualifikuar relativisht mirë - Kapacitetet kërkimore në fushën e hidrogeologjisë; • Sistemi i ujërave të zeza: <ul style="list-style-type: none"> - Njohuri teknike në trajtimin e ujërave të zeza; - Kapaciteti kërkimor në fushën e trajtimit të ujërave të zeza. • Administrimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta <ul style="list-style-type: none"> - Njohuri në trajtimin e mbetjeve urbane; - Kapaciteti kërkimor në fushën e trajtimit; • Furnizimi me energji elektrike: <ul style="list-style-type: none"> - Konceptimi i furnizimit me energji elektrike bazohet në vlerësimin e kërkesave të së ardhmes; - Agjensitë financuese respektojnë këtë koncept dhe nxisin zbatimin e tij; - Rinovimi i rrjetit energjistik e sistemi i furnizimit sipas standarteve Europiane; • Telekomunikacioni <ul style="list-style-type: none"> - Prezenca e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme dhe fikse me kompani private; 	<ul style="list-style-type: none"> • Furnizimi me ujë: <ul style="list-style-type: none"> - Burime të mjaftueshme sipërfaqësore dhe nëntokësore ujore; - Furnizim i pamjaftueshëm me ujë, gjatë periudhave të thatësirës, me pasoja negative për biznesin, bujqësinë, turizmin dhe jetën private; - Humbje të mëdha të ujit të pijshëm, për shkak të rrjedhjeve masive në sistemin e tubacioneve dhe ndërhyrjeve të paligjshme (humbjet mesatare arrijnë në masën 45%); - Shpërdorimi i ujit të pijshëm, për shkak të çmimit të pa përshtatshëm (që bazohet te numri i krerëve për familje dhe jo në konsumin aktual); - Administrimi jo efektiv i ujërave; • Sistemi i ujërave të zeza: <ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, dhe si pasojë derdhja e ujërave të ndotur në kanalet kullues. • Administrimi dhe trajtimi i mbeturinave të ngurta: <ul style="list-style-type: none"> - Në gjithë zonën nuk ka një grumbullim e trajtim të rregullt të mbeturinave; - Mostrajtimi ekologjik i mbetjeve; • Furnizimi me energji elektrike <ul style="list-style-type: none"> - Paqëndrueshmëri në furnizim me energji elektrike - Rrjete të vjetër dhe administrim jo efektiv sistemit të furnizimit me energji; - Çmime të papërshtatshme për energjinë; - Nuk ka tradita në përdorim të energjisë diellore - Nuk ka tradita në përdorim të energjisë së erërave - Nuk ka tradita në përdorim të energjisë ujore • Telekomunikacioni <ul style="list-style-type: none"> - Mbulimi i pa mjaftueshëm i fshatrave; - Nuk ka sisteme të mjaftueshëm të parandalimit të zjarreve;

Avantazhet dhe dobësitë në lidhje me kushtet natyrore dhe mjedisin

AVANTAZHET	DOBËSITË
<ul style="list-style-type: none"> • Plani kombëtar i Veprimit për Mjedisin; • Disponueshmëria e burimeve ujore (rezervuarëve); • Tokat pjellore; • Kushte të favorshme klimatike; • Pejsazh interesant; • Cilësia e ajrit shumë e mirë; • Zbatim të Projekteve kombëtare për rehabilitimin e veprave kulluese; • Zbatim të Projektit të kombëtare për kalimin e pyjeve ne pyje komunal; Shkalla e lartë e erozionit në kodrat me pjerësi, për shkak të degradimit të pyjeve. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimet e paligjshme; • Niveli i lartë i ndotjes së ujit, për shkak të mos trajtimit të ujërave të zeza; • Ndotja, për shkak të mos trajtimit të mbeturinave urbane; • Teknologjitë dhe fabrikat e ndryshme janë kërcënuese për mjedisin; • Konflikti midis shkarkimit të hapur të ujërave të zeza dhe sistemit të kullimit; • Zonat lumore nuk janë marrë në konsideratë gjatë zhvillimit të aktiviteteve; • Mbeturinat e ngurta shkarkohen në vende të hapura dhe të shpërndara; • Plani Kombëtar i veprimit për Mjedisin nuk zbatohet;

Ndikimi njeriut në rajon

Nga çpyllëzimi, flora dhe fauna janë ekspozuar ndaj fenomenit me emrin njeri, duke vënë në kërcënim zhdukjen e habitateve të krijuara ndoshta 100-ra vjeçare . Sensibilizimi i komunitetit për ruajtjen e florës dhe faunës nuk është në nivelet e dëshiruara dhe si rrjedhojë ndodhin fenomene që çojnë në prishjen e ekuilibrave mjedisorë.

Zona në vazhdimësi duhet trajtuar me kujdes, duke pasur parasysh edhe vlerësimet e bëra më lart dhe në përputhje të plotë me planet zhvillimore për një zhvillim të qëndrueshëm të saj.

Vlerësimi dhe identifikimi i ndikimeve negative e pozitive gjatë ushtrimit të aktiviteteve

Lloji i ndikimit në tokë	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Ndryshime topografike të terrenit	x			x
Prishja e tokës bujqësore		x		x
Ndotja e tokës nga rrjedhjet	x			x
Ndotja e tokës nga mbetjet e ngurta	x			x
Ndotja e tokës nga depozitimet e llumrave		x		x
Lloji i ndikimit në cilësinë e ajrit	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Prodhimi i pluhurit	x			x

Lloji i ndikimit në florën dhe faunës	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Shkatërrimi i rëndësishëm i habitateve natyrore		X		X
Rrezikimi i ndërhyrjes në bimët e ujit		X		X
Ndërtimi i rrugëve të reja që kalojnë përmes zonës		X		X
Përçarje apo izolim të habitateve të egra		X		X
Interferencë midis rrugës natyrore të emigrimit të sisonëve		X		X

Lloji i ndikimit në ujë	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Trajtimi i ujrave të ndotur	X		X	
Ndotja e ujit prej pluhurit, plumbit, derdhjeve aksidentale dhe substancave të tjera		X		X
Impakti sekondar në ndotjen e ujit për toka bujqësore, ujrë nëntokësore etj.	X			X
Modifikim në drenazhimin e ujrave natyrore	X		X	
Ndotja e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore		X		X

Lloji i ndikimit në ndotjen nga zhurmat	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Rritja e nivelit ekzistues të zhurmave		X		X
Rritja e nivelit të zhurmave nga aktivitetit, makinave		X		X
Rritja e nivelit të zhurmave për njerëzit		X		X
Niveli më i lartë i zhurmave për kafshët		X		X

Lloji i ndikimit në përfitim të tokës	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Shkatërrim banesash		X		X
Ndryshime të rëndësishme në programet për të ardhmen e përdorimit të tokës		X		X
Rivendosje banesash		X		X
Shpronësime të tokës		X		X

Lloji i ndikimit për trashëgiminë kulturore	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Ndryshime apo dëmtime të zonave arkeologjike apo me vlerë historike e kulturore		X		X

Lloji i ndikimit në energji	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Përdorim i sasive të mëdha të karburantit për energji		x		x
Rritje të rëndësishme të kërkesave për burime ekzistuese të energjisë apo kërkesave për tipe të reja të energjisë		x		x

Lloji i ndikimit në interesin publik (infrastruktura)	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Hapja e komplekseve do të ketë apo jo nevojë për ndryshim në këtë fushë të interesit publik		x		x
Energji elektrike		x		x
Sistemin e komunikacionit		x		x
Sistemin e kanalizimit të ujrave të zeza e të bardha	x		x	
Sistemin e ujësjellësit		x		x
Mbetjet e ngurta dhe depozitimi i tyre		x		x

Lloji i ndikimit në shëndetin publik	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Krijimi i çfarëdo rreziku apo mundësie për dëmtimin e shëndetit të njerëzve		x		x
Krijimi i raportit të njerëzve me rreziqet e mundëshme për dëmtimin e shëndetit publik		x		x

Lloji i ndikimit në qarkullim dhe transport	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Shtime të rëndësishme të qarkullimit të automjeteve	x			x
Pakësime të vendqëndrimeve të automjeteve apo nevoja për vendqëndrime të reja	x			x
Ndikime të rëndësishme në sistemin e komunikacionit	x			x

10. NDIKIMET E MUNDSHME NE MJEDISIN NDERKUFITAR (NESE PROJEKTI KA NATYRE TE TILLE);

Ky projekt nuk ndodhet prane kufirit, pra nuk ka natyre te tille qe te ndikojne ne mjedisin nderkufitar.

KONKLUZIONE DHE DETYRA

- Materialët që dalin si rezultat i punës në objekt, të grumbullohen, transportohen dhe depozitohen në vendin e caktuar dhe në oraret e percaktuara nga Bashkia Prrenjas
- Transporti i mbeturinave të kryhet me automjete të mbuluara me mushama, me qëllim që të mos ketë ndotje të rrugës e të mjedisit me teresinë e tij.
- Gjate veprimtarisë në objekt të mbahet nën kontroll ndotja e ajrit brenda nivelit 90 mikrogram/m³ për pluhurin total (LGS) dhe 50 mikrogram/m³ për pluhurin e frymemarrjes (PM₁₀)
- Gjate proceseve të punës të merren të gjitha masat masat për minimizimin apo eliminimin e ndikimeve negative në mjedis.

PERFUNDIME

Perdorimi i elementeve të tilla si :

- Minimizimi i pluhurave gjate punës.
- Pastrimi i vazhdueshëm i makinerive dhe pajisjeve gjate punës
- Shtimi i gjelberimit në zonë.
- Të gjitha sa thame me sipër janë një sërë faktorësh që do të prodhonin një ndikim të fortë nga pikpamja e përmirësimit të parametrave mjedisorë urbane.

Mund të themi se investimi që do të kryhet nuk do të ketë efekte negative të rëndësishme në mjedis, duke qenë se është një aktivitet që nuk krijon premisa për ndotjen e mjedisit apo të sjellë pasoja negative në mjedis.

- Përfundimi me i rëndësishëm është se ndërtimi nuk ka ndikim të rëndësishëm negativ në mjedis.
- Gjate aktivitetit të saj dhe nuk do të shkaktojë ndotje të tokës.
- Me marrjen e masave në favor të mbrojtjes së mjedisit edhe ato pak elemente, që mund të kenë një ndikim të vogël në mjedis dhe që janë përmendur më lart do të kapërcehen.
- Aktiviteti në këtë objekt do të ketë efektet e tij pozitive në të gjitha drejtimet dhe sidomos ekonomike dhe të sigurisë.

“ANGERBA” shpk

- Aktiviteti do te paraqese nje ndikim minimal ne mjedis dhe me zbatimin e masave parandaluese, keto ndikime do te jene pothuajse fare te vogla.

Si perfundim mund te themi se efektet e ndertimit te objektit : **“Rikonstruksion dhe Afaltim i rruges se fshatit Gurre, Njesia Administrative Qukes”**, do te jene pozitive duke patur parasysh edhe kriteret e duhura per mbrojtjen e mjedisit.

Pergatiti :

“ANGERBA” shpk

Ing. Burhan HAFIZI

Ing. Arjola MAZARI